



Shteti 30 % i Qasshëm për Qytetarët

Prishtinë
Qershor 2013

Botues: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese – BIRN Kosova

Autore: Gresa Musliu

Redaktore dhe
këshilltare ligjore: Flutura Kusari

Kryeredaktore: Jeta Xharra

Lekturimi: Bekim Muhaxhiri

Të drejtat e autorit

BIRN-i mban të drejtat rreth këtij raporti. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike ose elektronike, përfshirë fotokopjimin dhe formatet e ngjashme, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate ose materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin.

Copyright © 2013 Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN.

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. E drejta për tu informuar	4
3. Vetëm 30 për qind nga 300 kërkesa kanë marrë përgjigje	8
4. Kërkesat për qasje në dokumente publike	9
4.1 Shpenzimet e udhëtimeve të kryeministrit dhe zëvendëskryeministrave	9
4.2 Kryeministria refuzon kërkesat në heshtje.....	11
4.3 Raporti për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Shkup	12
4.4 Lista e lobistëve dhe këshilltarëve të huaj të qeverisë	13
4.5 Prokurorët dhe gjykatësit e dënuar me masa disiplinore	14
4.6 Edhe gjykatat e prokuroritë fshehin dokumentet	14
4.7 Tentativë për heqjen e deklaratave të pasurisë nga formati online	15
4.8 Raportet financiare të partive politike.....	15
5. Kryeministria: Kemi ofruar përgjigje në 94 për qind të rasteve	16
6. Shembuj të zbatimit të ligjit.....	17
6.1 Teatri Kombëtar	17
6.2 Dhuratat e zyrtarëve të lartë	18
6.3 Faturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë të gjitha publike.....	18
6.4 Dosjet e kompanive sigurohen brenda ditës	18
6.5 Kontrata për pasaporta	19
7. Rekomandime.....	20
8. Model i kërkesës për qasje në dokumente publike	21
Rreth BIRN-it.....	22

1. Përmbledhje ekzekutive

Ndër instrumentet kryesore të shteteve demokratike janë transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve publike për veprimet e tyre. Si mekanizëm ligjor kryesor për të garantuar këtë transparencë konsiderohet e drejta e cila ia mundëson publikut të kërkojë dhe pranojë dokumente që kanë të bëjnë me interes publik. Kosova ka legjislacion të mirë që mundëson qasje në dokumente publike, mirëpo ky raport dëshmon që institucionet publike nuk e respektojnë këtë ligj, pasi që në shumë raste dhe pa të drejtë u mohojnë qytetarëve qasje në dokumente publike.

Për të kuptuar më mirë zbatimin e ligjit, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese ka monitoruar dhe testuar për më shumë se një vit këtë ligj, duke dërguar rreth 300 kërkesa për qasje në dokumente publike. Vetëm në 30 për qind të rasteve institucionet publike kanë kthyer përgjigje.

Shteti është treguar i mbyllur sidomos në lidhje me shpenzimet e buxhetit të Kosovës, dokumentet gjyqësore dhe raportet financiare të partive politike.

Nga këto kërkesa të dërguara del që institucioni më i mbyllur është Zyra e Kryeministrit të Kosovës e pasuar nga komuna e Prishtinës, Agjencioni Kadastral i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Gjatë monitorimit të këtij ligji BIRN-i ka kuptuar që Agjencioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucioni kryesor i cili tenton në vazhdimësi që përmes “rrugëve ligjore” të ndihmojë institucionet që të jenë të mbyllura ndaj publikut. Konkretisht iniciativa më e rrezikshme e këtij institucioni është tentimi i hapur për t’i hequr nga faqet e internetit deklaratat e pasurisë të zyrtarëve publikë, gjë që do të shënonte kthim mbrapa për standardet e transparencës të arritura në Kosovën e pas-luftës. Në një rast tjetër ky agjencion mohoi qasjen në faturat e shpenzimeve të udhëtimeve të zyrtarëve nën arsyetimin se mund të bëhet publike ndonjë dietë e tyre, dhe në këtë formë të cenohej privatësia e zyrtarit publik.

Në të njëjtën kohë janë identifikuar disa institucione më të hapura të cilat brenda afatit ligjor u janë përgjigjur kërkesave zyrtare të BIRN-it. Disa prej tyre janë Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve, Agjencioni Kundër Korrupsion dhe Zyra e Auditorit Gjeneral. Pra, më të hapura kanë qenë kryesisht institucionet e pavarura.

2. E drejta për tu informuar

Në Europë qasja në dokumente publike garantohet me rregulloren e Parlamentit Europian Nr. 1049/2001 e cila detajisht parashihet përfituesit e dokumenteve publike, definicionet, përjashtimet, procedimin e dokumenteve, përmbushjen e kërkesave dhe afatet kohore.

Kjo e drejtë që konsiderohet si garantues i transparencës, garantohet edhe me dy rekomandime të Këshillit Europian, respektivisht rekomandimin Nr. R (81) 19 për qasje në informacione që mbahen nga autoritetet publike¹ dhe rekomandimin R (2002) 2 për qasje në dokumente publike²,

¹ Shih rekomandimin [http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/cm/rec\(1981\)019_EN.asp](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/cm/rec(1981)019_EN.asp)

² Shih rekomandimin <https://ecd.coe.int/VieëDoc.jsp?id=262135>

sipas së cilave qytetarët europianë kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin dokumente publike dhe shtetet duhet të garantojnë këtë të drejtë.

Legjislacioni që garanton qasje në dokumentet publike është relativisht i ri. Sipas Article19, organizatës ndërkombtare që mirret me të drejtën në informacion,, në vitet '90 vetëm 13 shtete kanë pasur ligje që garantonin qasje në dokumente publike, ndërsa sot numri i këtyre shteteve arrin në 100.³

Sidoqoftë, legjislacioni i shteteve ballkanike si Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mal i Zi, Rumania dhe Serbia konsiderohet më i dobët. Sipas drejtoreshës së Qendrës Stabile për Gazetari Hulumtuese Sheila Coronel, “qasja në të dhënat publike në Ballkan është e zbehtë në krahasim me Europën Perëndimore apo Amerikën Veriore”⁴.

Përpara se të shpjegohet legjislacioni i Kosovës për qasje në dokumente publike është më rëndësi të bëhet dallimi në mes të informatave të siguruar sipas kërkesës së qasjes në dokumente publike dhe informatave të rrjedhuara (leaked documents).

Një dokument i rrjedhur, pra kur gazetari/ja siguron një dokument përmes një burimi ose në ndonjë mënyrë tjetër jozyrtare pa bërë kërkesë për qasje në dokumente publike nuk konsiderohet si dokument i marrë bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike. Rrjedhimisht, një gazetari e bazuar vetëm në dokumente të rrjedhura nuk konsiderohet gazetari hulumtuese. Sipas udhëzuesit për gazetari hulumtuese “Të gërmosh më thellë”, “Gazetaria ‘rrjedhëse’ nuk është gazetari hulumtuese. Një hetim mund të fillojë nga një rrjedhje por gazetarët duhet vet të bëjnë hulumtim, të verifikojnë informatën dhe të ofrojnë kontekstin”⁵

Legjislacioni në Kosovë garanton qasje në dokumente publike. Kjo është paraparë me Kushtetutën e Kosovës, të aprovuar në vitin 2008, ku sipas nenit 41 “secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike”. Por baza ligjore që garanton qasje në dokumente publike daton më herët se Kushtetuta. Ligji i parë për qasje në dokumente publike ekziston qysh në vitin 2007, kur edhe gazetarët, aktivistët e shoqërisë civile, qytetarët dhe akterët tjerë, fituan bazën ligjore për të kërkuar qasje në dokumente publike.

Ky ligj nuk kishte arritur kurrë të zbatohet me përpikëri, për çka Komisioni Europian, përmes raporteve të progresit, vazhdimisht ka kritikuar institucionet vendore. Më 2008, një vit pasi ligji kishte hyrë në fuqi, raporti i progresit thoshte se “zbatimi i ligjit për qasje në dokumente zyrtare duhet të përmirësohet”⁶ ndërsa një vit më pas, më 2009, i njëjti konkludonte se “ligji nuk është duke u zbatuar plotësisht”⁷.

³ Raporti International standards: Right to information, prill 2012, mund të gjendet në

http://www.article19.org/resources.php/resource/3024/en/international-standards:-right-to-information#_ftnref32

⁴ Të gërmosh më thellë, udhëzues për gazetarët hulumtues në Ballkan, botuar më 2009. Një kopje e këtij libri mund të sigurohet nga BIRN sipas kërkesës së të interesuarve të cilët mund të na kontaktojnë në kosova@birn.eu.com

⁵ Ibid

⁶ Raporti i Progresit për Kosovën 2008, faqe 15, mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/key_documents/reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf

⁷ Raporti i Progresit për Kosovën 2009, faqe 13, mund të gjendet në:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf

Instituti për Studime të Avancuara (GAP) në vitin 2010⁸, përmes një analize të zbatimit të ligjit për qasje në dokumente zyrtare, ka listuar disa prej aspekteve të këtij ligji që ishin vështirë të zbatueshme. Mes tyre ishte mungesa e regjistrave (atëkohë kërkohej nga institucionet që të mbanin regjistra të dokumenteve publike), nënvizohej se kërkesave të shtruara në formë elektronike u jepej më pak rëndësi, se atyre në kopje fizike, cekej mungesa e kontakteve online të personave përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave dhe raportimi i vogël i rasteve të moszbatimit të ligjit tek Avokati i Popullit⁹.

Tre vjet më vonë, në fund të vitit 2010, Kuvendi i Kosovës ka përmirësuar kornizën ligjore që u mundëson qytetarëve të ketë qasje në dokumente, duke aprovuar ligjin për qasje në dokumente publike (ky ligj nuk quhet më ligji për qasje në dokumente zyrtare).¹⁰

Ndonëse është ligj relativisht i mirë në teori, zbatimi i tij përsëri është kritikuar nga institucionet europiane, por edhe nga vetë Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Në vitin 2011, raporti i progresit thoshte se institucionet nuk posedojnë statistika për dokumentet e kërkuara.¹¹

Shumica e organizatave të pavarura të dala nga Kuvendi i Kosovës, por edhe gjyqësori e prokuroria, nuk kanë dashur të raportojnë në Qeveri lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike, thuhet në raportin e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës për qasje në dokumente publike për vitin 2011.¹²

Ligji aktual është më i favorshëm për kërkesat e dokumenteve në disa aspekte. Përderisa ligji i vjetër kërkonte decidivisht që kërkesa të bëhej në formë të shkruar, ligji aktual mundëson që kërkesat të bëhen “në çfarëdo mënyre”, që nënkupton formën me shkrim (e cila mund të dërgohet në zyrë edhe përmes postës), mundësinë e dërgimit përmes postës elektronike dhe gojarisht përmes telefonatave ose takimeve.¹³

Edhe në Maqedoni kërkesa mund të parashtrohet në tri mënyra: gojarisht, me shkrim dhe në formë elektronike. Në Shqipëri ndërkaq, forma e parashtrimit të kërkesës nuk është specifikuar me ligj, e në Serbi kërkesa duhet të bëhet patjetër me shkrim.

Nga mundësitë e ofruara me ligj, për shkak se shërbimet postare në Kosovë nuk janë të besueshme dhe shpesh përdoren nga autoritete publike si arsye për mospranime të letrave, shumica e kërkesave zyrtare që BIRN ka bërë janë dërguar njëkohësisht përmes postës elektronike, në kopjeje fizike në institucion/zyrë dhe përmes postës.

⁸ Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think Tank i formuar në tetor të 2007 në Kosovë. GAP ka qenë direkt pjesëmarrës në dhjetëra grupe punuese qeveritare për hartim të politikave dhe një numër i madh i dokumenteve publike që tani ndodhen në zbatim njohin kontributin e GAP gjatë procesit të hartimit të tyre. Më shumë informata për GAP mund të gjeni në: <http://www.institutigap.org>

⁹ Qasja në dokumente publike, GAP Institute, faqe 2, mund të gjendet në [http://www.institutigap.org/documents/59273_Qasja_ne_Dokumente_Publike\(GAPanalize\).pdf](http://www.institutigap.org/documents/59273_Qasja_ne_Dokumente_Publike(GAPanalize).pdf)

¹⁰ Lista e ligjeve në fuqi e publikuar në gazetën zyrtare, mund të gjendet në: [http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Lista%20e%20Ligjeve%20e%20Fuqi%20\(shqip\).pdf](http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Lista%20e%20Ligjeve%20e%20Fuqi%20(shqip).pdf)

¹¹ Raporti i Progresit, 2011, faqe 9, mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf

¹² Raporti gjithëpërfshirës për qasje në dokumente publike 2011, Zyra e Kryeministrit, 2011, fq. 6 http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Raporti_2011_Shqipp.pdf

¹³ Ligji për qasje në dokumente publike, neni 6 paragrafi 1, mund të gjendet në [http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20qasjen%20e%20dokumentet%20publike%20\(shqip\).pdf](http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20qasjen%20e%20dokumentet%20publike%20(shqip).pdf)

Një aspekt tjetër favorizues për publikun është afati kohor për kthimin e përgjigjes nga institucioni, i cili me ligjin e ri është zvogëluar në shtatë ditë, në krahasim me ligjin e kaluar që jepte 15 ditë afat. Rregullorja e Parlamentit Europian Nr. 1049/2001 për qasje në dokumente publike parasheh afatin kohor prej 15 ditësh me mundësi shtyrje vetëm në rast se dokumentet e kërkuara janë voluminoze.

Në Kosovë afati prej shtatë ditësh mund të shtyhet në dy raste - nëse informata ose dokumenti duhet të kërkohet jashtë institucionit publik dhe nëse me një kërkesë kërkohen disa informata ose dokumente publike, nga e njëjta palë.¹⁴

Ligji kërkon edhe caktimin e zyrtarëve që do të merren me kërkesat për dokumente publike. Sipas një hulumtimi të Gazetës Jeta në Kosovë,¹⁵ nëntëmbëdhjetë (19) ministrinë e Qeverisë së Kosovës kanë caktuar zyrtarët për trajtimin e kërkesave për dokumente publike. Por, caktimi i zyrtarëve është bërë një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në gusht 2011.¹⁶

Edhe pse këta zyrtarë janë caktuar, megjithatë në shumicën e ministrive emrat e tyre nuk figurojnë në faqet zyrtare, gjë që vështirëson dhe shpesh e bën të pamundur kontaktin më ta. BIRN-i në vazhdimësi ka vizituar faqet zyrtare të ministrive (sidomos pjesën ku shënon “kontakti”) dhe ka gjetur se aty nuk figurojnë emrat e zyrtarëve për qasje në dokumente publike.¹⁷ Në një rast është gjetur se vegëza kontaktit në faqen online të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural¹⁸ të lidhë me pagesat direkte të sektorit të drithërave, të blegtorisë dhe me projekte të tjera të kësaj ministrie.¹⁹

Një aspekt tjetër problematik i ligjit në Kosovë dhe i bazës ligjore europiane është se legjislativi kryesisht garanton qasje në dokumente, por jo edhe në informacione, sidomos sa i përket informacioneve verbale (të dhëna që mund të ofrohen gojarisht). Për këtë arsye, organizata kryesore europiane Access Info Europe, që mirret me qasjen në dokumente zyrtare, beson që në demokracinë e shekullit 21 është thelbësore që qytetarëve t’u garantohet e drejta që të dinë se çfarë vendime merren në emër të tyre. Prandaj, sipas kësaj organizate, kufizimi i së drejtës për të ditur vetëm në dokumente, për arsye ligjore, është koncept i vjetruar.²⁰

¹⁴ Ligji për qasje në dokumente publike, neni 6 paragrafi 1, mund të gjendet në

[http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20qasjen%20ne%20dokumentet%20publike%20\(shqip\).pdf](http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20qasjen%20ne%20dokumentet%20publike%20(shqip).pdf)

¹⁵ Gazeta Jeta në Kosovë është medium në gjuhën shqipe i nisur në Shtator, 2011, me synim ofrimin e informacionit objektiv dhe analizën e tij duke ndjekur standardet e gazetarisë botërore. Para së gjithash, ajo fokusohet në kualitetin e institucioneve publike me hulumtime përkatëse si zhanri i saj dominues i raportimit. Gazeta JnK është prodhim i Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese

¹⁶ Dokumentet Publike Pak të Qasshme, botuar më 28 janar 2013, mund të gjendet në

<http://gazetajnk.com/index.php?cid=1,3,4516>

¹⁷ Hera e fundit që BIRN ka vizituar faqet e internetit është 16 qershor 2013

¹⁸ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

¹⁹ Zyra për komunikim me publikun, MBPZHR <http://www.mbpzhr-ks.net/?id=4,724,738,766.a>

²⁰ Udhëzues për qasje në dokumentë të BE-së, Access Info, fq.14, mund të gjendet në:

http://www.access-info.org/documents/Access_Docs/Advancing/EU/EN_ONLINE_Guide_on_access_to_EU_Documents.pdf

3. Vetëm 30 për qind nga 300 kërkesa kanë marrë përgjigje

Që nga janari 2012 deri në maj 2013 Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese ka dërguar rreth 300 kërkesa zyrtare për qasje në *dokumente dhe informacione publike* në institucione kosovare, misione ndërkombëtare në vend dhe parti politike. Kërkesat janë bërë për nevoja të raportimit në Gazetën Jeta në Kosovë (gazetë kjo që botohet në formatin online), emisionet Jeta në Kosovë dhe Drejtësia në Kosovë dhe gazetën në gjuhën angleze Prishtina Insight.

Kërkesat janë dërguar në të gjitha ministritë e Qeverisë së Kosovës, në Zyrën e Kryeministrit, Këshillin e Pavarur të Mediave, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Agjencionin e Statistikave të Kosovës, Zyrën e Auditorit Gjeneral, Agjencionin për Regjistrimin e Biznesit të Kosovës, Agjencionin për Miniera dhe Minerale, Agjencionin Kosovar të Privatizimit, Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe Odën e Avokatëve të Kosovës.

Fokus i kërkesave për qasje në dokumente dërguar institucioneve publike kanë qenë kryesisht shpenzimet publike përmes faturave të paguara gjatë udhëtimeve jashtë shtetit, dokumentet që dëshmojnë përshtatshmërinë dhe zbatimin e kontratave publike të fituara nga kompanitë publike, vendimet disiplinore të formës së prerë të ndërmarra ndaj prokurorëve, gjykatësve dhe avokatëve, procesverbalet e ndryshme: si ato të negociatave Kosovë - Serbi dhe të mbledhjeve të agjencioneve të pavarura, regjistrave të donacioneve dhe kontributeve të partive politike si dhe kërkesat të tjera.

Nga numri total i kërkesave të dërguara në të gjitha institucionet, vetëm në rreth 100 ose 30 për qind të tyre ka pasur përgjigje. Këto përgjigje kanë qenë pozitive, pjesërisht pozitive dhe negative.

Prej 300 kërkesave të dërguara, rreth 100 prej tyre janë dërguar në Zyrën e Kryeministrit përmes së cilës është kërkuar qasje në dokumente publike dhe në informacione. Zyra e Kryeministrit ka refuzuar në heshtje shumicën e kërkesave të bëra, duke mos u përgjigjur fare në to. Janë disa raste të rralla kur kjo zyrë është përgjigjur në kërkesa.

Në disa raste arsyetimet e insticioneve për moslejim në qasje në dokumente kanë qenë në shpërputhje me bazën ligjore dhe për nevoja të këtij raporti, BIRN-i ka përzgjedhur disa përgjigje të çuditshme.²¹

a) Gjatë vitit 2012 BIRN-i, përmes Gazetës Jeta në Kosovë, ka bërë kërkesë në Komunën e Prishtinës për qasje në dokumentacionin e lëshimit të një leje ndërtimi në Komunën e Prishtinës. Në përgjigjen e saj të shkurtit 2012, komuna ka treguar vështirësi në sigurimin e këtij dokumenti. “Dokumenti i kërkuar është lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Ambientit Jetësor, por me organizimin e ri të pushtetit lokal, ky departament ka kaluar në një objekt të ri”, thuhet në përgjigjen e komunës.

Trasferimi nga objekti i vjetër, në atë të riun, ka bërë që Arkivi i Komunës së Prishtinës të çrregullohet, thuhet në përgjigjen e komunës. “Në hapësirat e reja të departamentit të përmendur

²¹ Të gjitha këto raste janë publikuar në Gazetën Jeta në Kosovë në shkrimin me titull “Qeveria Mbyllet Duke u Kujdesur për Dietën e Zyrtarëve”, 28 dhjetor 2012, mund të gjendet në <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,4235>

ka qenë i organizuar arkivi i brendshëm, por me kalimin e këtij organi në objektin e ri të komunës një pjesë e dokumentacionit është bartur në obejktin e ri, por jo edhe pjesa dërrmuese e tij, me ç'rast arkivi është çrregulluar dukshëm".²²

b) Pas Prishtinës, Agjencia Kadastrale e Kosovës është institucioni tjetër i rëndësishëm që ka kufizuar BIRN-in në qasjen në të dhënat publike. Në dy raste kur është kërkuar qasje në të dhëna për parcela kadastrale, AKK-ja ka kthyer përgjigje negative, duke rekomanduar që kërkesa t'i bëhej një institucioni tjetër, përkatësisht Komunës së Prishtinës.

Pra AKK nuk e posedon atë informatë mirëpo ky veprim është në kundërshtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, sipas së cilit, nëse institucioni ku është kërkuar dokumenti nuk e posedon atë, ai institucion duhet të drejtojë kërkesën në institucion përkatës. "Nëse institucioni publik nuk posedon, nuk disponon, ose nuk e mbikëqyrë informatën, e ka njohuri për organin gjegjës..., është i detyruar që kërkesën t'ia përcjellë organit gjegjës", thuhet në paragrafin 2, të nenit 7, të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.²³

c) Në një rast tjetër, më 20 prill 2012, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale kishte publikuar "opinion në lidhje me qasjen dhe publikimin e faturave të shpenzimeve të kryeministrit dhe zv.kryeministrave".²⁴

Sipas këtij opinionioni faturat duhen të mbahen fshehtë sepse "publikimi i faturave tejkalon qëllimin e kërkesës për transparencë të shpenzimeve publike dhe cenon privatësinë e kryeministrit dhe të zv.kryeministrave" dhe se "faturat e ushqimit mund të përmbajnë të dhëna të cilat mund të zbulojnë përkatësinë fetare ose gjendjen shëndetësore të zyrtarëve".²⁵

4. Kërkesat për qasje në dokumente publike

4.1 Shpenzimet e udhëtimeve të kryeministrit dhe zëvendëskryeministrave

BIRN-i në vitin 2012 ka kërkuar nga Zyra e Kryeministrit (ZKM) qasje në faturat e shpenzimeve të shefit të ekzekutivit Hashim Thaçi dhe gjashtë zëvendëskryeministrave të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacollit, Hajredin Kuçit, Mimoza Kusari-Lilës, Sillobodan Petroviqit, Edita Tahirit dhe Bujar Bukoshit, gjatë udhëtimeve dhe takimeve - të kryera përmes pagesave nga kartela e tyre zyrtare. ZKM ka ofruar totalin e shumës së shpenzuar, por jo edhe kopjen e faturave ashtu siç ishte precizuar në kërkesë.

Lidhur me përgjigjen jo të plotë të ZKM-së, BIRN-i ka ushtruar ankesë në institucionin e Avokatit të Popullit i cili kishte kërkuar pastaj nga Kryeministria publikimin e faturave. Më pas, Zyra e Kryeministrit i ishte drejtuar Agjencionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke e pyetur nëse kërkesa e BIRN-it cenonte të dhënat personale.

Për këtë kërkesë, ASHMDP-ja për herë të parë që nga themelimi i saj më 23 qershor 2011 ka nxjerrë opinion me të cilin konstaton se "qasja në faturat e shpenzimeve të zyrtarëve të lartë

²² Ibid

²³ Ibid

²⁴ Ky rast mund të gjendet i shpjeguar në detaje më poshtë

²⁵ Ibid

shtetërorë prek të dhëna personale të ndjeshme dhe privatësinë e kryeministrit dhe zëvendëskryeministrave”.²⁶ Në opinion shtohet se “faturat e ushqimit përmbajnë të dhëna të cilat mund të zbulojnë përkatësinë fetare ose gjendjen shëndetësore të zyrtarëve”. Pra, sipas ASHMDhP-së, këto fatura nuk mund të lëshoheshin pasi përmbajnë llojin e ushqimit dhe pijeve të konsumuara gjatë takimeve zyrtare, nga të cilat mund të prejdhikohet gjendja shëndetësore dhe përkatësia fetare e zyrtarëve.²⁷

Gjithashtu, nga agjencia është konsideruar se me publikimin e faturave do të zbuloheshin edhe të dhënat e personave të tretë, të cilët “mund të prejdhikojnë interesat komerciale të kompanive”. Pra sipas kësaj agjencie duke zbuluar faturat e shpenzimeve mund të zbulohen edhe të dhëna që kanë të bëjnë me kompaninë që ka ofruar shërbime për zyrtarë të institucioneve publike.

Ky konstatim është në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila më 2007 në rastin që ka ndodhur në Moldavi të revistës Timpful Info Magazine dhe kompanisë Anghel²⁸ ka vendosur se “kur një kompani private vendos të marrë pjesë në transaksione që kanë të bëjnë me fonde të konsiderueshme publike, vullnetarisht i ekspozohet një kontrolli më të madh nga opinioni publik”²⁹.

Rrjedhimisht, edhe në Kosovë, ASHMDP nuk duhet të mbrojë kompanitë private nëse ato janë të përfshira në transaksione që kanë të bëjnë me fonde publike.

“Në veçanti, nëse ngrihen akuza se një transaksion i fondeve publike është i dyshimtë, kompania duhet të pranojë kritika nga publiku”, thuhet në vendimin e gjykatës.³⁰

Një analogji me kërkesën për qasje në shpenzimet e qeveritarëve është edhe rasti në lidhje me shpenzimet e zyrtarëve në Britaninë e Madhe. Rrjeti i njohur mediatik BBC gjatë vitit 2008 kishte kërkuar qasje në shpenzimet e deputetëve të parlamentit britanez. Fillimisht Parlamenti kishte deklaruar se dhënia e detajeve të dokumenteve të kërkuara nga BBC do të mund të

²⁶ Shih opinion e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 30 prill 2012, mund të gjendet në http://www.amdp-rks.org/repository/docs/Opinion_per_faturat.pdf

²⁷ Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe i raporton atij në baza vjetore. ASHMDP ofron këshilla për Kuvendin e Republikës së Kosovës, qeverinë qendrore dhe locale, të gjithë ushtruesit e pushtetit publik në Kosovë por edhe institucionet private lidhur me çështjet për mbrojtjen e të dhënave personale. Agjencia kryesohet nga këshilli, i cili përbëhet nga mbikëqyrësi kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetërorë ndërsa vendimet e këshillit merren me shumicë të thjeshtë. Aktualisht ky agjencion drejtohet nga Ruzhdi Jashari mbikëqyrës kryesor shtetëror, Mentor Hoxhaj zëvendës mbikëqyrës kryesor shtetëror dhe Bekim Demiri, Ramadan Qehaja dhe Aleksandar Spasic si mbikëqyrës shtetëror. Të gjithë mbikëqyrësit janë njerëz të qeverisë pasi që propozohen nga vet qeveria mirëpo emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

²⁸ Rasti Timpful Info Magazine & Anghel v Moldova ka të bëjë me publikimin e një shkrimi kritikues nga Timpful Magazine për blerjen e veturave të shtrenjta nga qeveria e Moldovës dhe mos publikimin e të dhënave për tenderët lidhur me blerjen e tyre. Qeveria dhe dy kompani të përfshira në shkrim kishin paditur gazetën duke konsideruar se artikulli ishte shpifës dhe se nuk kishte interes publik për të botuar këtë shkrim. Tri gjykata, përfshirë atë Supreme në Moldovë kishin dënuar gazetën për shpifje por Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur që shteti moldov ka shkelur nenin 10 të konventës europiane për të drejtat e njeriut e cila garanton të drejtën për tu shprehur dhe për të marrë informacione.

²⁹ Rasti Timpful Info Magazine & Anghel v Moldova, 2007, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, mund të gjendet në: <http://echr.ketse.com/doc/42864.05-en-20071127/vieë/>

³⁰ Ibid

rrezikonte ndonjërin nga zyrtarët e lartë shtetëror. Megjithatë, gjykata kishte vendosur që t'i jep përparësi interesit publik duke lejuar kështu qasjen në shpenzimet në fjalë.³¹

Nga gjashtë zëvendëskryeministra, vetëm zëvendësministri dhe njëkohësisht ministri i administrimit të pushtetit lokal Slavisha Petrovic në shtator 2012 ka lejuar BIRN-in që të ketë qasje në faturat e shpenzimeve të bëra gjatë udhëtimeve zyrtare. Drejtoresha e zyrës për informim, Lumnije Demi, ka dërguar në mënyrë elektronike dhe brenda afatit kohor të gjitha faturat e shpenzimeve të zëvendëskryeministrit Petrovic. Faturat kanë qenë të skenuara dhe përmbajnë detaje si për shembull hotelin, datën dhe kohën e qëndrimit, shumën e paguar dhe përshkrimin e artikujve në rast se është bërë pagesë në restaruant.³² Ndryshe, edhe ministrja e integriteteve europiane Vlora Çitaku ka lejuar qasje në faturat e shpenzimeve të bëra gjatë udhëtimeve jashtë vendit.³³

4.2 Kryeministria refuzon kërkesat në heshtje

Në maj të vitit 2012 Zyra e Kryeministrit të Kosovës publikoi raportin e parë për zbatimin e ligjit për qasje në dokumente publike. Në fjalën e rastit, zëvendëskryeministri i cili njëkohësisht është edhe ministër i drejtësisë Hajredin Kuçi, kishte deklaruar se “është orientim i qartë i institucioneve qendrore e lokale që të respektohet ligji për qasje në dokumente publike.” “Mbi të gjitha t'i mundësohet publikut dhe mediave të kenë informacionet e parapara me ligj, për çdo aktivitet që kanë mundësi të marrin” kishte deklaruar Kuçi.³⁴ Mirëpo kur kjo ministri u testua disa herë nga BIRN-i lidhur me qasje në dokumente publike që janë më të ndjeshme ai nuk është shprehur i gatshëm që ta zbatojë këtë ligj dhe ka refuzuar qasjen duke mos kthyer fare përgjigje.³⁵

Në mars 2013, BIRN-i përmes Gazetës Jeta në Kosovë ka pritur më kot për javë të tëra përgjigje nga zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi lidhur me qasje në raportet financiare të Partisë Demokratike të Kosovës ku ai shërben si nënkryetar i parë së kësaj partie.

Në një rast tjetër, gazeta ka siguruar një dokument të lëshuar nga Kuçi të cilin ia kishte nisur drejtorit të Agjencisë e Kosovës për Inteligjencë, me të cilin kishte kërkuar hetim në burgun e Dubravës. Si pasojë, disa persona ishin degraduar në pozitë. BIRN-i ka kërkuar verifikimin e këtij dokumenti, por ministria dhe ministri asnjëherë nuk e ka trajtuar atë kërkesë.³⁶

³¹ Parlamenti humb betejën në luftën për shpenzime, prill 2008, mund të gjendet në: http://neës.bbc.co.uk/2/hi/uk_neës/politics/7404031.stm

³² BIRN ka kërkuar qasje në shpenzimet e bëra gjatë periudhës kohore 5 shkurt 2011 deri më 31 gusht 2012

³³ Dokumentet nga Ministria e Integriteteve Evropiane janë kërkuar nga BIRN në gusht 2011 dhe janë kthyer brenda afatit kohor të paraparë me ligjin për qasje në dokumente publike.

³⁴ ZKM publikon Raportin e parë për realizimin e së drejtës së qasjes në dokumente publike, mund të gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/index.php/2009/03/repository/docs/Plani_i_Veprimit_per_Reformen_ne_Menagjimin_e_financave_publike.pdf?page=1,9,2888

³⁵ Përderisa Ministri i Drejtësisë është përgjegjur në kërkesat për pyetje dhe intervistë në emisionin Drejtësia në Kosovë dhe Jeta në Kosovë, një gatishmëri e ngjashme për të dhënë informatë nuk është vërejtur kur janë kërkuar qasje në dokumenta prej kësaj Ministrie.

³⁶ Gazeta Jeta në Kosovë, Kërkesa e Kuçit Pasohet me Hetim për Sinqeritet Nga AKI, 25 mars 2013, mund të gjendet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,5113>

Në tetor 2012 BIRN përmes Gazetës Jeta në Kosovë ka kërkuar nga MD-ja qasje në projektligjin për prokurorinë speciale të Republikës së Kosovës i cili ishte dashur të figuronte në faqen zyrtare të kësaj ministrie por është refuzuar nga kjo Ministri nën arsyetimin se projektligji duhet të kërkohej në Këshillin Prokurorial, të cilët ishin anëtarë të grupit punues të projektligjit. BIRN ka kërkuar nga Këshilli Prokurorial por i njëjti është përgjigjur se kërkesa duhet t'i bëhet Ministrisë së Drejtësisë. Arsyeja e kërkesës është se në draftin e këtij projektligji të siguroar nga gazeta përmes burimeve ishte paraparë një dhomë e veçantë penale për të trajtuar rastet e mundshme të korrupsionit për zyrtarët më të lartë të vendit, ndonëse kushtetuta garanton barazi para ligjit.³⁷

4.3 Raporti për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Shkup

BIRN-i ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës qasje në kopjen e raportit të punës së kompanisë “EGIS BCEOM International” rreth ndërtimit të autostradës Prishtinë-Shkup. Interesi publik për monitorimin e ndërtimit të kësaj autostrade është i lartë, pasi që në media është përfolur që kap vlerën prej qindra miliona euro .

Për këtë kërkesë, sekretari i përgjithshëm i kësaj ministrie në bazë të vendimit nr. 2284/2011, kishte aprovuar qasjen në dokumente. Megjithatë, zyrtarë të tjerë të kësaj ministrie nuk kanë zbatuar vendimin e sekretarit. Në disa raste kur zyrtarët e BIRN-it kanë shkuar në ministri për të kërkuar dokumentet janë paraqitur zyrtarë të ndryshëm dhe jo vetëm një zyrtar për qasje në dokumente publike.

BIRN-i përsëri i është drejtuar Avokatit të Popullit (IAP), i cili disa herë i kishte drejtuar letër zyrtare ministrisë duke kërkuar të informohet lidhur me veprimet e ndërmarra nga ky institucion në lidhje me kërkesën e BIRN-it. Pavarësisht kësaj, Ministria e Infrastrukturës nuk ka kthyer asnjëherë përgjigje.

Si rezultat, IAP ka konsideruar se Ministria e Infrastrukturës ka refuzuar të bashkëpunojë me Avokatin e Popullit dhe se “kjo mënyrë e sjelljes dhe heshtja e ministrisë është arsye e mjaftueshme për fillimin e procedurave administrative ndaj personave përgjegjës për komunikim”. Në një raport të veçantë që mban datën 25 tetor 2012, IAP ka kritikuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe ka urdhëruar këtë ministri që t'i përgjigjet IAP, gjë që nuk ka ndodhur.

Në këtë raport, Avokati i Popullit ka dhënë tri rekomandime për këtë ministri, përkatësisht:

- a) Ministria e Infrastrukturës duhet të fillojë procedurat administrative, duke përfshirë edhe marrjen e masave disiplinore, ndaj zyrtarëve përgjegjës;
- b) duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, për të siguroar që të gjithë punonjësit në përgjegjësinë e ministrisë të njoftohen përmes një vendimi se kanë obligim ligjor që t'u përgjigjen kërkesave të IAP dhe se
- c) ministria duhet të informojë IAP-in lidhur me çdo veprim të ndërmarrë, si përgjigje ndaj këtij raporti.

³⁷ Gazeta Jeta në Kosovë, “Gjykatë” e Veçantë për të Fuqishmit, mund të gjendet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1.979.3487>

4.4 Lista e lobistëve dhe këshilltarëve të huaj të qeverisë

BIRN-i ka kërkuar në janar 2012 nga Zyra e Kryeministrit qasje në listën e këshilltarëve të huaj dhe lobistëve, përfshirë të dhënat e tyre, pagën dhe periudhën e punësimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Arsyeja e kërkesës ka qenë nënshkrimi i kontratës njëvjeçare më 29 gusht 2011 me vlerë prej 600,000 dollarësh në mes të Qeverisë dhe kompanisë lobuese amerikane Patton Boggs. Kompania do të jetë e angazhuar për "nxitjen e investimeve dhe mundësitë tregtare për Kosovën, si dhe për të mbledhur fonde nga programet e ndihmës së huaj" thuhej në kontratë.³⁸

Kërkesa për qasje në dokumente është bërë si vazhdimësi e raportimit për këtë kompani lobuese për të cilën Qeveria në vitin 2010 kishte vendosur që t'i ofronte marrëveshje duke anashkaluar të gjitha procedurat e tenderimit. Prishtina Insight kishte raportuar lidhur me këtë rast në atë kohë gjë që kishte rezultuar me anulimin e kësaj marrëveshje nga ana e Qeverisë.³⁹

ZKM prapë ka heshtur dhe kështu BIRN-i i është drejtuar Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit pas katër muajsh i është drejtuar ZKM-së, së cilës i ka kërkuar ta njoftojë atë me veprimet e ndërmarra rreth kërkesës së BIRN-it. Për këtë IAP kishte konsideruar se ZKM do të duhej të i përgjigjej BIRN-it me kohë dhe atë në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, me rastin e parashtrimit të kërkesës në Zyrën e Kryeministrit.

Edhe në këtë kërkesë, AShMDP-ja ka vendosur se lista e kërkuar nga BIRN-i përmban të dhëna të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me këshilltarët e huaj dhe lobistët dhe duke pasur parasysh se këto të dhëna tregojnë për mënyrën e punës së tyre, zbulimi i të dhënave në fjalë do të mund të prodhojë efekte në punën e tyre profesionale. Por, ky argument nuk vlen kur dihet se të gjithë lobistët amerikan janë të obliguar t'i deklarojnë fondet e tyre që i marrin në departamentin e shtetit amerikan.

Detaje të kontratës⁴⁰ mes Patton Boggs dhe ministrisë janë të publikuara në internet që kërkohet me ligj në SHBA dhe mund të gjenden në faqen e internetit të Foreign Agents Registration Act, www.fara.gov.

Përveç në SHBA edhe në Europë është krijuar praktikë e zbulimit të çështjeve që kanë të bëjnë me lobim. Në dhjetor 2009 gazetari i The Times, Dominic Kennedy, kishte kërkuar nga ministri skocezë informata lidhur me lobimin e Princit të Ëales për çështje mjedisore tek autoritetet lokale të këtij vendi. Ministri kishin refuzuar kërkesën nën arsyetimin se një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim me mbrojtjen e të dhënave personale. Gazetari Kennedy i pakënaqur me vendimin ishte ankuar tek komisionari për informim i cili kishte vendosur që gazeta ka të drejtë dhe se ato dokumente duhet të publikohen.⁴¹

³⁸ Gazeta Jeta në Kosovë, "Lobuesi Sekret" i Kosovës, 9 nëntor 2011, mund të gjendet në <http://gazetajnk.com/?cid=1.3.565>

³⁹ Shih njoftimin e Kryeministrit për anulimin e marrëveshjes, <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1.9.1720>

⁴⁰ Shih kontratën: <http://www.fara.gov/docs/2165-Exhibit-AB-20110831-33.pdf>

⁴¹ Komisioneri Skocez për Informim është zyrtar publik i emëruar nga Mbretëresha por i nominuar nga Parlamenti i Skotlandës. dhe është përgjegjës për zbatimin dhe promovimin e ligjeve për qasje në dokumente publike në këtë vend. Shih vendimin <http://www.itpublicknoledge.info/UploadedFiles/Decision039-2011.pdf>

4.5 Prokurorët dhe gjykatësit e dënuar me masa disiplinore

Në tetor 2012 BIRN-i ka kërkuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës qasje në vendimet përfundimtare të sanksioneve/masave për gjykatësit dhe prokurorët të cilët kanë bërë shkelje disiplinore si pasojë e sjelljes së pahijshme. Të dy institucionet, përkatësisht KPK dhe KGjK, nuk kanë lejuar qasje në emrat e prokurorëve dhe gjykatësve.

BIRN konsideron se është me rëndësi të publikohen emrat e gjykatësve dhe prokurorëve ndaj të cilëve ka përfunduar procedura disiplinore sepse në këtë formë sistemi gjyqësor i cili vazhdimisht kritikohet për korrupsion do të mund të dëshmonte se është duke ndërmarrë masa për përmirësimin e problemeve. Mirëpo, nëse kjo informatë fshihet nga publiku atëherë krijohet përshtypja që i gjithë gjyqësori dhe prokuroria janë të korruptuar e jo vetëm individë të caktuar.

Mënyra se si praktikisht reagon këto institucione të drejtësisë ishte ashtu që, fillimisht KPK-ja kërkoi takim me zyrtarë të BIRN-it për të “diskutuar” kërkesën, anipse mbajtja e takimeve për të diskutuar kërkesat nuk është obligim ligjor. Përfundimisht, KPK-ja ka marrë vendim me disa javë vonesë për të refuzuar kërkesën me arsyetimin se “dokumentet e kërkuara përmbajnë të dhëna personale dhe shkelin të drejtën e privatësisë”. Lidhur me këtë ashtu siç parasheh ligji për qasje në dokumente publike BIRN-i ka paditur Këshillin Prokurorial të Kosovës.⁴²

Ngjashëm, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka lejuar qasje në emrat e gjykatësve ndaj të cilëve janë shqiptuar masa disiplinore për sjellje të pahijshme dhe joprofessionale. KGjK-ja i ka ofruar BIRN-it një listë që tregon numrin e gjykatësve me masa disiplinore, por në këtë dokument janë fshirë emrat e tyre. Më vonë, KGjK-ja është arsyetuar se është duke punuar në “rregullore të brendshme” me të cilat do të rregullohet qasja në emrat e gjykatësve.

4.6 Edhe gjykatat e prokuroritë fshehin dokumentet

Aktakuza është dokument me të cilin prokuroritë ushtrojnë padi ndaj një ose më shumë personave kur dyshojnë se është kryer një vepër penale. Një dokument i tillë në bazë të ligjit për qasje në dokumente publike është publik, pasi që nuk bie në asnjërën nga përjashtimet e këtij ligji që mund të gjenden në nenin 12. Ky nen precizon se përjashtime bëhen vetëm në rastet kur dokumenti mund të cenojë sigurinë kombëtare, mbrojtjen dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, sigurinë publike, parandalimin, hulumtimin dhe ndjekjen e aktiviteteve penale, hulumtimet disiplinore dhe të tjera.

Mirëpo, në praktikë në Kosovë qasja në aktakuza mohohet me këmbëngulësi si nga prokuroria e Kosovës ashtu edhe nga ajo e misionit evropian për sundim të ligjit EULEX. Aktualisht nuk ka asnjë faqe interneti në Kosovë ku publikohen aktakuzat e ngritura nga prokuroria. BIRN-i gjatë 2012-ës dhe pjesës së parë të 2013-ës ka kërkuar qasje në më shumë se 50 aktakuza.

Prokuroria e Kosovës dhe ajo e EULEX-it kanë refuzuar kërkesat nën arsyetimin se aktakuzat duhet të merren në gjykatë.⁴³ Në anën tjetër, gjykatat nuk kanë ofruar qasje në aktakuza duke

⁴² Padia është përgatitur dhe dorëzuar në bashkëpunim të ngushtë me kampanjën “Drejtësia dhe Qytetarët”. Kjo kampanjë është një lëvizje që sjell së bashku qytetarët dhe grupet e shoqërisë civile në Kosovë që të punojnë për reformën në sistemin e drejtësisë dhe për të promovuar ndryshim përmes avokimit publik. Më shumë informata rreth kampanjës mund të gjeni në: justiceandthepeople.org

⁴³ Në raste shumë të rralla prokurorët vendorë kanë ofruar kopje të aktakuzave

drejtuar zyrtarët e BIRN-it në prokurori. E njëjta vlen edhe për aktvendime për paraburgosjen e ndonjë të pandehuri, ankesat për lirim nga paraburgimi dhe dokumentet të tjera të ndërlidhura me procese gjyqësore.

Mohimi i të drejtës për të pasur qasje në këto dokumente dhe jotransparenca e gjykatave dhe prokurorive në këtë drejtim rrezikon objektivitetin e medieve, pasi që ato detyrohen të raportojnë vetëm anën e avokatëve mbrojtës të të pandehurve, të cilët në disa raste kanë shfrytëzuar mediat për të argumentuar vetëm anën e të akuzuarve duke krijuar përceptim të rrjeshëm publik rreth rastit që në të shumtën e rasteve ka qenë edhe denigrim e e punës së prokurorit të shtetit.

Në Mbretërinë e Bashkuar aktakuzat dhe provat tjera që përdoren në seanca gjyqësore, si hartat dhe fotografitë (përfshirë fotografitë e të akuzuarve), xhirimet të cilat tregojnë vendin e krimit, konfisikimin e sendeve (armë, drogë, gjësende të vjedhura) etj., janë dokumente publike.⁴⁴

4.7 Tentativë për heqjen e deklaratave të pasurisë nga formati online

Një ndër iniciativat më të dëmshme për standardet e transparencës dhe demokracisë në Kosovën e pasluftës është përpjekja e Agjencionit për Mbrojtjen e të Dhënave Shtetërore për t'i hequr deklaratat e pasurive të zyrtarëve publik të Kosovës nga interneti. Më 16 korrik 2012, Gazeta Jeta në Kosovë ka raportuar lidhur me këtë iniciativë e cila është konfirmuar nga zëvendës mbikqyrësi kryesor shtetëror Mentor Hoxhaj. Sipas Hoxhajt, arsyeja kryesore që ka shtyrë Agjencionin të ndërmarrë një iniciativë të tillë qëndron në “rreziqet” që mund të sjellë moszbatimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. “Ne duhet të jemi të sinqertë në lidhje me rreziqet që ekzistojnë sa i përket publikimit të të dhënave në internet. Në momentin e parë që të dhënat dalin në internet dhe aty del edhe pasuria që ne ose ju e keni atëherë kur të dilni jashtë [vendit] mund të jeni cak i ndonjë sulmi”, kishte deklaruar Hoxhaj në korrik 2012.⁴⁵

Aktualisht, çdo vit rreth katër mijë deklarata të pasurisë të zyrtarëve që mbajnë poste publike mund të gjenden në faqen zyrtare të Agjencisë Kundër Korrupsion, gjë që kërkohet edhe me ligjin që e rregullon punën e këtij agjencioni. Mirëpo, AShMDP-ja ka kërkuar urgjentisht heqjen e këtyre deklaratave nën arsyetimin se mund të “rrezikohen” zyrtarët që kanë pasuri më të madhe. Për më tepër, zyrtarët e kontrollit të këtij agjencioni kanë deklaruar se në rast se është e nevojshme do ta dërgojnë ligjin për agjencionin kundër-korrupsion në gjykatën kushtetuese. Deri më tani, BIRN-i nuk ka njohuri nëse është ndërmarrë ndonjë veprim konkret. Deklaratat e pasurive janë dokumente thelbësore që gazetarët dhe qytetarët tjerë të mund të gjurmojnë pasurimin eventual të zyrtarëve publikë dhe lidhjen e tyre me biznese.

4.8 Raportet financiare të partive politike

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, institucion i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, nuk është treguar i gatshëm që të ofrojë qasje në raportet financiare të partive politike të cilat, sipas ligjit për financimin e subjekteve politike, duhet të jenë të publikuara online.

⁴⁴ Ligjet kryesore për gazetarë të McNae, Mark Hanna, Mike Dodd, botues Oxford, faqe 150,

⁴⁵ Gazeta Jeta në Kosovë, “Pushiteti nuk i do më deklaratat e pasurisë në Internet”, 16 korrik 2012, mund të gjendet në <http://gazetajnk.com/?cid=1,2,2687>

Në faqen zyrtare të KQZ-së figurojnë vetëm raportet financiare të partive politike për vitin 2010 dhe 2011, por mungojnë vitet paraprake dhe ato të vitit 2012.⁴⁶ Në mars dhe prill 2013, BIRN-i ka kërkuar qasje në raportet financiare të partive politike në KQZ për vitin 2012 dhe ka arritur të marrë këto informacione, ndonëse ndjeshëm më vonë se me afatet kohore të parapara me ligj. Në mënyrë që të sigurohet qasja në këto raporte, BIRN-i ka zhvilluar më shumë se tri takime me zyrtarë të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Çertifikim.

BIRN-i po ashtu ka kërkuar nga partitë politike si Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Aleanca për Kosovën e Re dhe Lëvizja Vetvendosje, qasje në regjistrat financiarë. Bazuar në ligjin për financimin e subjeteve politike raportet financiare janë dokumente publike mirëpo përveç Lëvizjes Vetëvendosje asnjëra nga këto parti nuk ka ofruar qasje në raporte financiare. Lëvizja Vetëvendosje ka ofruar të gjitha dokumentet e kërkuara nga BIRN-i brenda afatit kohor. E njëjta parti ka të publikuar këto raporte edhe në faqen zyrtare të internetit.

5. Kryeministria: Kemi ofruar përgjigje në 94 për qind të rasteve

Zyra e Kryeministrit të Kosovës është e obliguar që çdo vit të publikojë raport gjithëpërfshirës, përmes së cilit njofton publikun lidhur me zbatimin e ligjit për qasje në dokumente publike.

Përderisa në maj 2012 Zyra e Kryeministrit kishte lansuar raportin në një konferencë publike ku ishin të pranishme edhe mediat, një gjë e tillë nuk ka ndodhur në vitin 2013.⁴⁷

Në mars, ZKM-ja ka publikuar raportin vetëm online. Raporti nuk ka datë, por mban vetëm vitin 2013. BIRN-i ka kërkuar sqarime nga drejtori i zyrës për informim në ZKM përse ky raport nuk është lansuar përmes një ngjarjeje publike, por nuk ka marrë përgjigje.

Sipas raportit të ZKM-së, Presidenca, Kuvendi dhe Gjykata Kushtetuese kanë pranuar gjithsej 47 kërkesa që kanë ardhur edhe nga gazetarët të cilët kryesisht kërkojnë të dhëna për buxhet, shpenzime dhe statistika.⁴⁸

Numrin më të madh të kërkesave, sipas raportit, e ka pranuar Qeveria e Kosovës dhe në 94 për qind të rasteve përgjigjet janë kthyer brenda afatit.⁴⁹

Sipas raportit, agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës kanë pranuar 86 kërkesa dhe në 79 për qind të tyre është lejuar qasje, ndërmarrjet publike kanë pranuar 8 kërkesa dhe në të gjitha kanë lejuar qasje, ndërsa komunat kanë pranuar 588 kërkesa dhe kanë lejuar qasje në 530 prej tyre.⁵⁰

⁴⁶ Raportet mund të gjenden në <http://kqz-ks.org/sq/raportet-financiare-auditimet>

⁴⁷ Shih njoftimin e Zyrës së Kryeministrit për lansimin e raportit më 29 maj 2012, http://www.kryeministri-ks.net/index.php/2009/03/repository/docs/Plani_i_Veprimit_per_Reformen_ne_Menagjimin_e_financave_publike.pdf?page=1,9,2888

⁴⁸ Raport gjithëpërfshirës i institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, Qeveria e Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 13, mund të gjendet në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/1_Shqipp.pdf

⁴⁹ Ibid

⁵⁰ Ibid

Zyra e Kryeministrit në raportin gjithëpërfshirës të institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, edhe këtë vit ka listuar një varg problemesh në lidhje me implementimin e këtij ligji.

Në bazë të këtij raporti, numri i institucioneve të themeluara nga Kuvendi i Kosovës të cilat raportojnë për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike mbetet i vogël pasi që, sipas ZKM-së, agjencionet e pavarura e konsiderojnë si ndërhyrje në punën e tyre faktin që duhet të raportojnë për statistika rreth zbatimit të ligjit për qasje në dokumente publike. Gjithashtu, raporti nënvizon si problematik nxjerrjen e vendimit me shkrim lidhur me lejimin ose refuzimin e qasjes në dokumentin e kërkuar sepse “institucione të ndryshme e kanë rregulluar në mënyra të ndryshme çështjen e vendimit me shkrim”. Së treti përmendet mungesa e fushatave informuese të cilat do të sqaronin se kush është pronar i dokumenteve të kërkuara dhe se si duhet të shkruhet një kërkesë. Mirëpo, raporti i ZKM-së nuk ofron ndonjë shembull të kërkesës për qasje në dokumente publike.

Në një raport tjetër, të publikuar në qershor 2012 nga Qendra për Politika dhe Avokim e cila ka bërë monitorimin e zbatimit të ligjit përmes dërgimit të kërkesave në institucionet publike në dy periudha të ndryshme kohore, thuhet se në rastin e parë institucionet janë përgjigjur në rreth 40 për qind të rasteve, ndërsa në fazën e dytë në rreth 60 për qind të tyre.⁵¹

Sipas këtij raporti, sfidë kryesore mbetet mënyra e parashtrimit të kërkesës dhe dërgimit të kërkesës, pasi që institucionet shpeshherë kërkojnë që kërkesa të jetë e parashtruar me shkrim përmes dokumentit fizik edhe pse kjo nuk është e obliguar me ligj. Sfidë tjetër, sipas raportit, mbetet edhe mungesa e konfirmimit të pranimit të kërkesave dhe mungesa e koordimit të zyrtarëve brenda institucionit.⁵²

6. Shembuj të zbatimit të ligjit

6.1 Teatri Kombëtar

Në shkurt të këtij viti BIRN-i ka kërkuar nga Ministria e Kulturës qasje të plotë në të gjitha dosjet e kandidatëve për drejtor të Teatrit Kombëtar (duke përfshirë CV-të, letrat e motivimit dhe arsyetimet për kandidim). Ministria e Kulturës ka kërkuar opinion ligjor nga Agjensioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke e pyetur nëse publikimi i këtyre të dhënave përbën shkelje të së drejtave personale.

ASHMDP-ja ka nxjerrë opinion pozitiv⁵³ dhe ka lejuar qasjen në CV. Konkretisht, ASHMDP-ja ka vendosur të lejojë qasje në informata të caktuara të cilat kanë qenë të kërkuara në konkursin publik, si p.sh: emri, përgatitja profesionale, përvoja e punës, aftësitë e tjera siç janë ato kompjuterike, njohja e gjuhëve të huaja etj.

Më të drejtë, Agjensioni konsideronte se këto të dhëna janë të mjaftueshme për të kënaqur interesat e publikut dhe nuk janë të tepërta në arritjen qëllimit dhe nuk komprometojnë dinjitetin

⁵¹ E drejta për qasje në dokumente publike, rezultatet dhe sfidat e zbatimit, Qendra për Politika dhe Avokim, qershor 2012

⁵² Ibid

⁵³ Opinion i Agjencisë rreth kërkesës për qasje në dosjet e kandidatëve për drejtor të teatrit kombëtar, ASHMDP, 27 shkurt 2013, mund të gjendet në http://www.amdp-rks.org/repository/docs/Opinion_i_MKRS.pdf

e subjektit të të dhënave dhe se kështu gjendet ekuilibri në mes të mbrojtjes së të dhënave personale dhe interesit publik.⁵⁴

6.2 Dhuratat e zyrtarëve të lartë

Në dhjetor 2012 BIRN-i ka kërkuar nga Agjencioni Kundër Korrupsionit qasje në regjistrin e dhuratave të deklaruara nga zyrtarët e lartë publikë, të cilët në bazë të ligjit për këtë institucion obligohen të deklarojnë dhuratat e pranuar. AKK-ja brenda afatit kohor të paraparë me ligjin për qasje në dokumente publike ka ofruar qasje në regjistrin e plotë të dhuratave.

Si rezultat, BIRN-i ka zbuluar se ky regjistër nuk plotësohet siç kërkohet dhe ka bërë publike dhuratat e ndryshme që zyrtarët publikë kanë pranuar brenda një viti. Sipas të dhënave, të gjithë zyrtarët e lartë publikë kanë deklaruar se kanë pranuar 86 dhurata brenda një viti. Asnjë prej tyre nuk është deputet i Kuvendit Kosovës. Kryeministri Thaçi ka pranuar vetëm një dhuratë rasti e cila nuk bëhej publike. Komuna e Skenderajt ka pranuar kamionë, autobus dhe veturë si dhuratë. Disa të tjerë pranuan libra, veshje, verë, vazo e kafe.

Në përgjithësi, AKK-ja mund të konsiderohet si institucion i cili respekton ligjin për qasje në dokumente publike, pasi që ofron qasje të lehtë dhe të shpejtë në dokumentet që posedon. Mirëpo, i njëjti vlerësim nuk mund të jepet edhe për përmbajtjen e dokumenteve siç janë vendimet e ndryshme që AKK-ja merr në kuadër të kompetencave të saj.⁵⁵

6.3 Faturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë të gjitha publike

BIRN-i ka kërkuar kopjet e faturave për karburante dhe shpenzimet e faturuara për dreka/darka të zyrtarëve të këtij institucioni për periudhën Janar 2011 - 31 Gusht 2012. Duke qenë shumë efikase, kjo zyrë brenda pesë ditësh ka përgatitur materialin voluminoz prej rreth 100 faqesh me shpenzime dhe fatura, të cilin BIRN-i e ka pranuar në kopje fizike nga ana e zyrës për komunikim të zyrës së auditorit. ZAP-i nuk ka përdorur të njëjtën arsyetim si ZKM-ja, se faturat mund të prekin interesat komerciale të palëve të treta. Për më tepër, Zyra e Auditorit ka ofruar gatishmëri për shpjegime shtesë lidhur me faturat, në rast se një gjë e tillë do të konsiderohej e nevojshme nga BIRN-i.

6.4 Dosjet e kompanive sigurohen brenda ditës

Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për më shumë se një vit sa BIRN-i ka parashtruar kërkesa për qasje në dosjet e kompanive, është treguar jashtëzakonisht i hapur duke lejuar qasje pa vështirësi në këto dosje. Në disa raste, ARBK-ja ka ofruar dosjet e kompanive brenda ditës, gjë që vlerësohet lartë sidomos nga mediat, duke pasur parasysh nxitimin për të publikuar lajme. Këto dosje janë të rëndësishme sepse u mundësojnë mediave dhe shoqërisë civile që të shikojnë aksionarët dhe të dhënat tjera për kompani të ndryshme, të cilat përfitojnë

⁵⁴ Ndër tjerash në këtë opinion thuhej se të dhënat që gjenden në dosjet e përgjithshme të kandidatëve përmbajnë të dhëna personale të tepërta, si për shembull konfirmimi nga gjykata për të kalurën kriminale të kandidatëve, andaj ASHMDP nuk ka lejuar publikimin edhe të këtij dokumenti.

⁵⁵ Një ndër vendimet e fundit të AKK-së lidhur me konfliktin e interesit të drejtorit të gazetës zyrtare Naser Canolli të publikuar më 13 maj 2013 është vendim i dykuptimtë, i paqartë dhe i cili nuk specifikon nëse një zyrtar është në konflikt interesi ose jo. Ky vendim i sugjeron Canollit që të lexojë ligjin që nënkupton se vetë zyrtari duhet të vijë në përfundim nëse është në konflikt interesi ose jo, anipse AKK-ja është e thirrur që të ofrojë opinion nëse një zyrtar i lartë gjendet në konflikt interesi. Opinion për Naser Canollin, Agjensioni Kundër Korrupsionit, 13 maj 2013, mund të gjendet në: [http://www.akk-ks.org/repository/docs/OPINION-NASER%20CANOLLI%20\(1\).pdf](http://www.akk-ks.org/repository/docs/OPINION-NASER%20CANOLLI%20(1).pdf)

tenderë publikë. Sipas këtyre dosjeve, Gazeta Jeta në Kosovë në gusht 2012 shpërfaqti se një ndër kompanitë që konkurronte për të fituar kompaninë telefonike vendase (PTK) përbëhej nga aksionarë që kishin aksione edhe në kompaninë më të madhe private telefonike (Ipko) e që mund të ishte në kundërshtim me rregullat e konkurrencës.⁵⁶ Ky aksionarë më vonë u tërhoq nga gara për të blerë PTK-në.

6.5 Kontrata për pasaporta

Ministria e Punëve të Brendshme ka ofruar qasje të plotë në kontratën problematike për prodhimin e pasaportave, të lidhur ndërmjet kompanisë austriake OeSD dhe MPB-së, në janar 2013. Kontrata ishte me rëndësi të madhe për interesin publik, pasi që muaj më herët ishte zbuluar se kompania e kontraktuar nga qeveria nuk kishte pranuar 1.4 milionë euro pagesa, anipse ministria deklaronte se ka bërë këtë pagesë. Si rezultat një person është arrestuar dhe hetime të hollëshishme janë duke u zhvilluar nga Misioni European për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Mirëpo, MPB-ja nuk ka ofruar dokumente tjera në lidhje me pasaportat biometrike siç janë faturat e paguara nga ky institucion për kompaninë austriake nën arsyetimin se janë nën hetime. Ajo ia ka ofruar BIRN-it ka ofruar vetëm shumën dhe datat e pagesave.

⁵⁶ Gazeta Jeta në Kosovë, Aksionet "Sekrete" të Albright-it në IPKO, 27 gusht 2007, mund të gjendet në: <http://gazetajn.com/?cid=1,987,2991>

7. Rekomandime

1. Institucionet duhet të përgjigjen në të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, duke përfshirë kërkesat e parashtruara në formë të shkruar, me e-mail ose në formën verbale;
2. Institucionet duhet të kenë konsideratë më të lartë për çështjet në interes publik, para se të refuzojnë kërkesat për qasje në dokumente publike;
3. Institucionet duhet të publikojnë në faqet e tyre zyrtare në internet emrat dhe kontaktet e personave zyrtarë për qasje në dokumente publike;
4. Institucionet publike duhet të pranojnë dhe respektojnë edhe kërkesat verbale për qasje në dokumente publike;
5. Institucionet duhet të trajtojnë me seriozitet jo vetëm kërkesat për qasje në dokumente, por edhe në informacione;
6. Përgjigjet negative duhet të jepen me shkrim dhe të jenë të mirarsyetuara;
7. Institucionet publike duhet të ndërmarrin fushata të vazhdueshme vetëdijësuese për të informuar publikun për të drejtën e tyre në qasjen në dokumente publike.
8. Institucionet duhet të ofrojnë trajnime të vazhdueshme për zyrtarë për qasje në dokumente publike lidhur me aplikimin e legjislacionit që ka të bëjë me të drejtën për të dituar

8. Model i kërkesës për qasje në dokumente publike



Nga: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN

Për: Zyra e Kryeministrit, ndërtesa e Qeverisë e Republikës së Kosovës, sheshi Nëna Terezë, 10,000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Lidhur: Kërkesë për qasje në dokumente publike

Data: 12 shtator 2012

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) me anë të kësaj kërkesë, kërkon të i mundësohet qasja në të dhënat të cilat tregojnë shpenzimet faturuara të bëra nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, Z. Hashim Thaçi dhe gjashtë Zëvendëskryeministrave të Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, Hajredin Kuçi, Mimoza Kusari-Lila, Slobodan Petroviq, Edita Tahiri dhe Bujar Bukoshi, shpenzime këto të bëra gjatë udhëtimeve/takimeve të tyre zyrtare, për priudhen kohore 15 shkurt 2011 – 31 Gusht 2012.

Në bazë të ligjit për qasje në dokumente publike, **Nr 03/L-215 ne kërkojmë qasje në këto dokumente zyrtare** dhe rrjedhimisht kërkojmë që të na ofroni të dhënat që përfshijnë, por nuk kufizohen:

- *Shpenzimet e Kryeministrit dhe gjashtë Zëvendëskryeministrave të Republikës së Kosovës, të shpenzuara nga kredit kartela e tyre zyrtare, gjatë udhëtimeve, takimeve dhe drekave zyrtare.*
- *Kopje të të gjitha faturave për këto shpenzime, pa numër të kartelës dhe pa numër të xhirrollogarisë.*

Ju lutem që këto të dhëna të na dergoni me e-mail në flutura@birn.eu.com, përmes postës në adresën: Jeta në Kosovë, Mensa e Studentëve, Kati i Parë, 10000, Prishtinë, Kosovë ose të na ftoni të vijmë t'i marrim në zyren tuaj.

Ju faleminderit paraprakisht,

Flutura Kusari
Këshilltare Ligjore
flutura@birn.eu.com;
Tel: 044/236-66

Rreth BIRN-it

BIRN-i u themelua në verë të vitit 2005 me qëllim të zhvillimit të mediave, ngritjes së kapaciteteve të gazetarisë si dhe të shtyrjes së debatit publik për reformimin politik dhe ekonomik të vendit. Organizata përbëhet nga një grup i ngushtë i redaktorëve dhe trajnuesve që merret me gazetari analitike dhe hulumtuese mbi tema komplekse politike, ekonomike dhe sociale. BIRN-i ekziston për t'i dhënë impuls tranzicionit demokratik në Kosovë, duke ofruar gazetari cilësore për një sferë të varfër të informimit publik, me qëllim të përkrahjes së transparencës dhe llogaridhënies. www.birn.eu.com

Gazeta Jeta në Kosovë - është medium në gjuhën shqipe i nisur në shtator 2011, me synim ofrimin e informacionit objektiv dhe analizën e tij, duke ndjekur standardet e gazetarisë botërore. Para së gjithash, ajo fokusohet në kualitetin e institucioneve publike me hulumtime përkatëse, si zhanri i saj dominues i raportimit. Gazeta ka krijuar identitetin e saj me hulumtime, analiza, kolumne dhe lajme nga ngjarjet aktuale në vend dhe botë. Në dhjetor 2012, dy artikuj të gazetajnk.com janë shpërblyer me çmimin për raportimin më të mirë kundër korrupsionit nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe në të njëtin vit ajo ka fituar më së shumti, tri çmime, përfshirë çmimin e Gazetarit të Vitit, që jepen nga Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës. www.gazetajnk.com

Emisioni Jeta në Kosovë – është një nga emisionet javore më të shikuara në Kosovë, i cili transmetohet në Televizionin Publik të Kosovës. Jeta në Kosovë adreson çështje nga fusha politike, ekonomike, sociale me fokus të veçantë në korrupsion, konflikt të interesit dhe llogaridhënie të institucioneve publike. Deri më tani, janë prodhuar 470 debate, të cilat kanë shërbyer për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me akterët kryesorë dhe vendimmarrësit në Kosovë Nga viti 2006 deri më tani, emisioni Jeta në Kosovë ka fituar më shumë se katër çmime për storjet më të mira televizive. www.jetanekosove.com

Emisioni Drejtësia në Kosovë - i jep fokus të veçantë fushës së gjyqësorit, policisë dhe sigurisë. Pjesa më interesante e emisionit është rubrika “Policia” e cila pasqyron aksionet në terren të policisë së Kosovës, për të cilat aksione BIRN-i ka të drejtën ekskluzive nga Policia e Kosovës t'i xhirojë dhe transmetojë. Drejtësia në Kosovë deri më tani ka fituar dy çmime për storjen më të mirë televizive dhe një çmim për storjen më të mirë të vitit. . www.drejtesianekosove.com

Prishtina Insight - është gazeta e vetme në Kosovë e botuar në gjuhën angleze e cila çdo dy javë, boton më shumë se 2000 kopje tirazh. Prishtina Insight ka fituar reputacion të fortë në mesin e vendimmarrësve vendorë dhe ndërkombëtarë. Analizat e thelluara hulumtuese rregullisht ripublikohen të plota në mediat kosovare, duke siguruar kështu lexueshmëri më të gjerë dhe të larmishme. Gjithashtu, Prishtina Insight ndihmon në zhvillimin e bashkëpunimit në mes organizatave joqeveritare, donatorëve dhe shoqërisë civile në përgjithësi. www.prishtinainsight.com